



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 24

2001

Maj

### P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.8776 datë 26.4.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.7932, datë 17.5.1995, nr.8286, datë 16.2.1998, nr.8392, datë 2.9.1998 dhe nr.8575, datë 3.2.2000.	733
Ligj nr.8777 datë 26.4.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin teknik, financiar dhe asistencën humanitare”.....	737
Ligj nr. 8778 datë 26.4.2001	Për ratifikimin e “Konventës penale për korrupsionin”.....	742
Ligj nr.8779 datë 26.4.2001	Për një shtesë në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8166, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; nr.8445, datë 21.1.1999 dhe nr.8714, datë 15.12.2000.....	756

Ligj nr.8781 datë 3.5.2001	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” .....	757
Dekret nr.3018 datë 21.5.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	761
Dekret nr.3019 datë 21.5.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	762
Dekret nr.3020 datë 21.5.2001	Për emërimin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.....	762
Vendim nr.291 datë 12.5.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.514, datë 3.7.1995 të Këshillit të Ministrave “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore, qendrore dhe organeve të pushtetit vendor” .....	763
Vendim nr.297 datë 12.5.2001	Për regjistrimin hipotekor të pasurive të shoqërive huamarrëse në administrim, kur u mungon leja e ndërtimit ose kur objekti nuk ka përfunduar.....	763
Vendim nr.298 datë 12.5.2001	Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 21.1.1999 të Këshillit të Ministrave “Për mbylljen e llogarisë së ish-fondacionit “Demokracia Popullore Xhaferri” dhe kalimin e fondeve të mbetura për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale”.....	764
Vendim nr.299 datë 12.5.2001	Për regjistrimin për shitje të sipërfaqeve të trojeve të objekteve në pronësi të shoqërive huamarrëse në administrim.....	765
Vendim nr.300 datë 12.5.2001	Për pagesën e vlerës së truallit të shoqërive huamarrëse për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale.....	766
	<i>Vendim</i> (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dhimitër Vasil Avrami.....	768
	<i>Kërkesë</i> për shpallje të zhdukur të shtetases Shaqe Ramaj.....	768

**L I G J**  
**Nr.8776, datë 26.4.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR  
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME  
LIGJET NR.7932, DATË 17.5.1995, NR.8286, DATË 16.2.1998, NR.8392, DATË 2.9.1998  
DHE NR.8575, DATË 3.2.2000**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, ndryshuar me ligjet nr.7932, datë 17.5.1995, nr.8286, datë 16.2.1998, nr.8392, datë 2.9.1998 dhe nr.8575, datë 3.2.2000 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në titullin e nenit 2, pas fjalës “Sigurimet” shtohet fjala “shoqërore të”.  
Në paragrafin e parë të nenit 2, pas fjalës “Sigurimi” shtohet fjala “shoqëror”.

Neni 2

Në paragrafin e tretë të nenit 4, pas fjalëve “Sigurimi shoqëror” shtohet fjala “suplementar” dhe para fjalisë “bëhet sipas kriterëve të caktuara me ligj të veçantë” shtohet fjalia “Për Policinë e Shtetit dhe për Shërbimin Informativ Shtetëror.”.

Neni 3

Paragrafi i fundit i nenit 9 ndryshohet si vijon:  
“Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike të zhvilluar më parë për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me ligje dhe me vendime të Këshillit të Ministrave.”

Neni 4

Në paragrafin e tretë të nenit 12, pas fjalisë “mund të sigurohen vullnetarisht” shtohet fjalia “, duke paguar kontribute deri në nivelin maksimal, për të përfituar”.

Neni 5

Në pikën 4 të nenit 13, fjala “gjobën” zëvendësohet me fjalën “kamatëvonesën”.

Neni 6

Në nenin 15, në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, fjalët “afati i derdhjes së tyre” zëvendësohen me fjalët “afati i pagimit të tyre”.

Pas paragrafit të dytë të nenit 15 shtohen këta paragrafë:

“Punëdhënësi detyrohet të depozitojë çdo muaj listëpagesat, sipas formatit tip, në agjencinë e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga pagesa e kontributeve.

Punëdhënësi paguan çdo muaj kontributet me urdhërshirim tip dhe shumat e paguara duhet të përputhen me shumat e listëpagesave.

Pagesa e kontributeve për të vetëpunësuarit, për punëdhënësit privatë dhe për të vetëpunësuarit në bujqësi mund të bëhet gjatë vitit kalendarik një herë në tre muaj. Afati i pagesës së tyre është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarik.”

Në paragrafin e fundit të nenit 15 shtohet fjalia “dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit”.

## Neni 7

Neni 16 ndryshohet si vijon:

“Sanksionet

### 1. Kamatëvonesat

Kamatëvonesa për kontributet e paguara jashtë afateve të caktuara do të jetë:

- 0.05 për qind për ditë të shumës së papaguar të kontributeve, duke filluar nga dita kur pagesa duhej të ishte bërë, për rastet kur është bërë regjistrimi në organet e sigurimeve shoqërore.

- 0.1 për qind për ditë të shumës së papaguar të kontributeve, duke filluar nga dita kur pagesa duhej të ishte bërë, për rastet kur nuk është bërë regjistrimi në organet e sigurimeve shoqërore.

Kamatëvonesa për një përcaktim më të vogël të shumës së kontributeve do të jetë 0.1 për qind për ditë të shumës së kontributeve të paguara më pak.

Në mbarim të çdo viti kalendarik, kamatëvonesat e arrira i shtohen shumës së detyrimeve kontributive, në bazë të së cilës është bërë llogaritja e parë.

### 2. Gjoha

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përveç pagesës së kontributit, shkeljet e mëposhtme dënohen me gjobë:

- Për paraqitjen me vonesë për regjistrimin e fillimit të veprimtarisë ekonomike punëdhënësi dënohet me gjobë 100 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuarit dënohet me gjobë 30 000 lekë.

- Për paraqitjen me vonesë për regjistrimin e vazhdimit të veprimtarisë ekonomike ose për mosdeklarim të ndërprerjes së përkohshme të veprimtarisë ekonomike, punëdhënësi dënohet me gjobë 60 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuarit dënohet me gjobë 10 000 lekë.

- Për vonesë në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar në sigurimet shoqërore, punëdhënësi dënohet me gjobë 30 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuarit dënohet me gjobë 10 000 lekë.

- Kur në dokumentacionin e paraqitur në sigurimet shoqërore nga punëdhënësi ka të dhëna të pasakta me qëllim pakësimin e shumës së kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 70 000 lekë.

- Kur punëdhënësi ka mbajtur nga paga e të punësuarit kontributin për sigurimet shoqërore, por nuk e paguan brenda afatit të caktuar, masa e gjobës është 50 000 lekë.

- Kur punëdhënësi ka mbajtur nga paga e të punësuarit kontributin për sigurimet shoqërore, por e paguan me vonesë në llogarinë e sigurimeve shoqërore, masa e gjobës është 20 000 lekë.”

## Neni 8

Në nenin 17, pas fjalëve “kundër vendimeve” shtohen fjalët “të gjobave, të inspektorëve”.

## Neni 9

Në nenin 18 në fjalinë e parë, fjala “taksat” zëvendësohet me fjalët “detyrimet fiskale”.

Në fund të paragrafit të dytë të nenit 18 shtohet fjalia “dhe ekzekutohet nga zyra e përmbarimit”.

## Neni 10

Në pikën 1 të nenit 31 hiqet fjala “bazë”.

## Neni 11

Në nenin 33, titulli “Shtesë pensioni për shtyrje të datës së daljes në pension” bëhet: “Shtesë pensioni” dhe përmbajtja e tij ndryshohet si vijon:

“Shtesë pensioni

I siguruari, që ka plotësuar kushtet për pension të plotë pleqërie, sipas neneve 31 dhe 92 të këtij ligji, merr një shtesë prej 4 për qind të pensionit të plotë për çdo vit që shtyhet dalja në pension në rast se:

a) vazhdon të jetë në marrëdhënie pune, paguan kontribute dhe pensionin e kërkon në një datë të mëvonshme nga data e plotësimit të kushteve;

b) ndërpret pensionin dhe vazhdon të punojë, paguan kontribute dhe e kërkon përsëri atë në një datë të mëvonshme.

Pensionin, në çdo rast, nuk mund të jetë më i madh se 80 për qind e pagës neto mesatare të 3 viteve rresht në 10 vitet e fundit të punës.”.

## Neni 12

Në nenin 41 bëhen këto ndryshime dhe riformulime:

- Shkronja “b” e pikës 1 riformulohet si vijon:

“b) 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë.”

- Paragrafi i dytë i pikës 1 të nenit 41 riformulohet si vijon:

“Kur nuk merret pensioni i parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension. Kur pjesëtarë në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 për qind.”

Fjalitë e dytë e pikës 2 e nenit 41 riformulohet si vijon:

“Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 për qind e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 për qind e tij.”

## Neni 13

Pikat 4 dhe 5 të nenit 52 bëhen pika 4, si më poshtë:

“4. Në rastet kur personi i siguruar vdes nga një aksident në punë ose sëmundje profesionale, masa e pensionit familjar për personat pasjetues, do të jetë ajo e përcaktuar në nenin 41 të këtij ligji.”

## Neni 14

Titulli i nenit 62 bëhet “E drejta për përfitim”.

## Neni 15

Në nenin 74 pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) Me kërkesë të punëdhënësve vendos për ngritjen e kamatëvonesave për një periudhë të caktuar kohe dhe për pagimin e tyre në një periudhë të mëvonshme, por jo më shumë se një vit financiar pa të drejtë përsëritjeje, në ato raste kur pagesa e menjëhershme e kamatëvonesave do të bënte të pamundur vazhdimin e veprimtarisë ekonomike që ndodhet në vështirësi financiare.”

## Neni 16

Neni 79 ndryshohet si vijon:

“Detyrimet e punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit”

Punëdhënësi është i detyruar:

- të regjistrojë në regjistrin vjetor të gjithë të punësuarit;
- të njoftojë agjencinë e sigurimeve shoqërore për të gjitha ndryshimet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet për sigurimin e të punësuarve;
- të bëjë sigurimin nga dita që i punësuarit fillon punë;
- të njoftojë zyrtarisht, një ditë para fillimit të punës së të punësuarit, agjencinë e sigurimeve shoqërore, e cila deklaron, në çdo rast, regjistrimin e të punësuarve të rinj.

Për ndërprerjen e punës ose për ditët e munguara në punë, kontributet do të llogariten në bazë të dokumentacionit përkatës, brenda kufijve të pagave me pagë ditore, sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Personat juridikë, publikë e privatë dhe personat fizikë, çdo rast të ndërprerjes së ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, brenda vitit kalendarik, duhet ta vërtetojnë nga organet e tatim-taksave.

Mbyllja e veprimtarisë, në çdo rast, vërtetohet me vendim gjykate.”

## Neni 17

Neni 81 ndryshohet si vijon:

“Regjistrimi

Personat juridikë, publikë e privatë dhe personat fizikë, për të fituar të drejtën e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike nga organet e tatim-taksave, duhet të jenë të regjistruar më parë në organet e sigurimeve shoqërore. Personat juridikë, publikë e privatë, për të fituar të drejtën e vazhdimin të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike duhet të marrin paraprakisht, për çdo vit kalendarik, vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve të sigurimeve shoqërore të vitit të mëparshëm.

Regjistrimi është një akt administrativ, që nuk tregon detyrim në mbulimin e sigurimit shoqëror.”

## Neni 18

Në nenin 85 pika 3, fjalët “kompetente lokale” zëvendësohen me fjalën “rajonale”.

## Neni 19

Në ato nene të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ku është përdorur termi “të ardhura” për të shprehur fjalën përfitime ose pensione, ky term zëvendësohet me termin “përfitime”. Ku është përdorur termi “kontribucione” zëvendësohet me termin “kontribute”. Ku është përdorur emërtimi “Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të të Përndjekurve Politikë” zëvendësohet me emërtimin “Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale”.

## Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3004, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Rexhep Meidani**

**L I G J**  
**Nr.8777, datë 26.4.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK, FINANCIAR DHE ASISTENCËN HUMANITARE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për bashkëpunimin teknik, financiar dhe asistencën humanitare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3005, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Rexhep Meidani

**MARRËVESHJE**

**MIDIS QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BASHKËPUNIMIN TEKNIK, FINANCIAR DHE HUMANITAR**

Qeveria e Konfederatës Zvicerane dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë  
(që më poshtë do t'i referohemi si dy Qeveritë)

Bazuar në lidhjet miqësore midis dy vendeve,

Me dëshirën e forcimit të mëtejshëm të këtyre lidhjeve dhe zhvillimit të një bashkëpunimi të frytshëm teknik dhe financiar midis dy vendeve,

Duke pasur parasysh se kjo asistencë, nëpërmjet Ndihmës Humanitare dhe zhvillimit të këtij bashkëpunimi teknik dhe financiar, do të kontribuojë në një përmirësim të kushteve sociale dhe ekonomike dhe promovimit të reformave politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri,

Duke ditur se Qeveria Shqiptare po vazhdon të kryejë reformat, me qëllim stabilizimin e një ekonomie tregu nën kushtet demokratike,

Duke riafirmuar qëllimin e tyre për vendosjen e një demokracie pluraliste, të bazuar në forcën e ligjit dhe respektin për të drejtat e njeriut,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

**Klauzola kryesore**

1.1 Respekti për principet demokratike dhe fundamentale të të drejtave të njeriut siç theksohen në veçanti në Aktin Final të Helsinkit, Kartën e Parisit për një Europë të Re dhe

Konventën mbi të Drejtat e Njeriut, frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të dy Qeverive dhe konstituon një element esencial të një ecjeje të njëtrajtshe me objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 2 **Objektivat**

2.1 Dy Qeveritë do të promovojnë, brenda kuadrit të legjislacionit të vendeve që iu përkasin, realizimin e projekteve të asistencës teknike dhe financiare në Shqipëri. Këto projekte do të mbështesin reformat politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri dhe do të lehtësojnë kostot ekonomike dhe sociale të procesit të transformimit.

2.2 Marrëveshja do të përcaktojë, gjithashtu, një kuadër rregullash dhe procedurash për planifikimin dhe zbatimin e këtyre projekteve.

2.3 Marrëveshja do të lehtësojë më tej ndihmën humanitare dhe emergjente të Zvicrës për Shqipërinë, në rast kërkese nga Qeveria Shqiptare.

## Neni 3 **Format e bashkëpunimit**

3.1 Bashkëpunimi do të kryhet në formën e Asistencës teknike dhe financiare ose edhe si një ndihmë humanitare dhe emergjente.

3.2 Një bashkëpunim i tillë do të kryhet në baza bilaterale ose në bashkëpunim me donatorë të tjerë ose organizata multilaterale.

### Asistencë Teknike

3.3 Asistenca teknike do të jepet në formën e transferimit të dijeve nëpërmjet trajnimeve shërbimeve konsultuese dhe në formën e shërbimeve, si edhe në pajisjet dhe materialet e nevojshme përkatëse për zbatimin me sukses të projekteve.

3.4 Projektet e ndërmarra nën asistencën teknike do t'i shërbejnë Shqipërisë dhe do të kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve politike, ekonomike dhe sociale të procesit të transformimit. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet:

- a) promovimit të tregtisë dhe investimeve ;
- b) zhvillimit të sektorit privat në ekonomi;
- c) mbështetjes së tranzicionit në sektorin social;
- d) konservimit dhe rehabilitimit të ambientit natyral;
- e) promovimit të shndërrimeve shkencore dhe kulturore.

### Asistenca Financiare

3.5 Asistenca financiare do t'i jepet në baza jo të rimbursueshme Qeverisë së Shqipërisë për financimin e të mirave, mallrave, pajisjeve dhe materialeve Zvicerane, për projektet prioritare, si edhe shërbime të lidhura me transferimin e dijeve për një zbatim të suksesshëm të projekteve.

3.6 Asistenca financiare do të jepet grant për infrastrukturën prioritare dhe projektet e rehabilitimit të cilat nuk janë komercialisht të realizueshme. Rëndësi e veçantë do t'i jepet projekteve të sektorit energjik, social, komunikativ, transportit publik dhe ambiental.

### Ndihma Humanitare

3.7.1 Grantet për emergjencë dhe ndihmë humanitare do të jepen mbi bazën, rast pas rasti, në përgjigje të një njohjeje ndërkombëtare të nevojave urgjente në popullatë, ardhur si pasojë e fatkeqësive natyrore ose katastrofave, krijuar nga vetë njerëzit.

## Neni 4 **Detyrat**

4.1 Për të lehtësuar zbatimin e çdo projekti, brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Qeveria Shqiptare duhet:



a) të lejojë kalimin e lirë nga taksat, detyrimet doganore, fiskale, detyrime të tjera dhe të gjitha pajisjet, shërbimet dhe materialin e sjellë si grant nga Qeveria Zvicerane, brenda qëllimit të kësaj Marrëveshjeje;

b) të japë lejet e nevojshme për importin dhe eksportin e pajisjeve të kërkuara për zbatimin e projekteve;

c) brenda kësaj Marrëveshjeje, t'u japë ekspertëve të huaj të ngarkuar me detyra në projekte dhe familjeve të tyre, pa pagesë, lejet e nevojshme të rezidencave dhe të punës, si edhe përjashtimin nga taksat, ngarkesat fiskale dhe detyrimeve doganore për importimin dhe riekportimin me kohë të caktuar të sendeve personale.

4.2 Për pagesat në monedhë lokale (lek) të fondeve homologe, Ministria Shqiptare e Financave do të hapë llogari speciale, në përputhje me legjislacionin shqiptar. Përdorimi i këtyre fondeve homologe do të vendoset më parë midis dy Qeverive. Të dy Qeveritë do të vendosin për strukturën më eficiente për përdorimin dhe administrimin e këtyre fondeve homologe.

## Neni 5

### **Klauzola Anti-Korrupsion**

5.1.1 Të dyja Qeveritë kanë një mendim të njëjtë në luftën kundër korrupsionit, e cila rrezikon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e burimeve të nevojshme për zhvillim dhe rrezikon panairët dhe konkurrencën e hapur, të bazuar në çmim dhe cilësi. Ato deklarojnë qëllimin e tyre për të kombinuar forcat e tyre për të luftuar korrupsionin dhe, veçanërisht, deklarojnë se çdo ofertë, dhuratë, pagesë apo benefit i çdo lloji konsiderohet si akt i jashtëligjshëm ose praktikë korrupsioni, e cila nuk është kryer dhe s'ka për t'u kryer, direkt ose indirekt çdo personi me qëllim përfitimin ose ekzekutimin e Marrëveshjes aktuale. Çdo veprim i këtij lloji përbën terren të mjaftueshëm për të anuluar Marrëveshjen aktuale, prokurimin ose përfundimin e shpërblimit ose për marrjen e çdo mase ndëshkuese, parashikuar nga ligji i aplikuar.

## Neni 6

### **Qëllimi dhe aplikimi**

6.1 Parashikimet e kësaj Marrëveshjeje do të aplikohen për:

a) projektet e rëna dakort midis dy Qeverive;

b) projekte me korporata ose institucione të llojit privat ose publik të secilit vend, nën të cilat të dy Qeveritë ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar kanë rënë dakort, bashkërisht, të aplikojnë pikë për pikë (mutatis mutandis) kushtet e Nenit 3.

6.2 Kjo Marrëveshje është e aplikueshme, gjithashtu, për projektet që vazhdojnë ose projektet që janë duke u përgatitur para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

6.3 Parashikimet e kësaj Marrëveshjeje do të aplikohen në mënyrë të njëjtë për operacionet e ndihmës humanitare dhe emergjencës Zvicerane në Shqipëri, të cilat do të sillen në rast katastrofe humane.

## Neni 7

### **Autoritetet Kompetente, procedurat dhe koordinimi**

7.1 Autoritetet Zvicerane kompetente për zbatimin e asistencës teknike dhe financiare janë:

1. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

2. Sekretariati i Shtetit për Punët Ekonomike e Departamentit Federal të Punëve Ekonomike të Zvicrës.

Të dy këto institucione – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Sekretariati i Shtetit për Punët Ekonomike (SECO) – janë të përfaqësuara në Shqipëri nga Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Ambasadën Zvicerane në Tiranë.

7.2.1 Autoritetet shqiptare kompetente për zbatimin e asistencës teknike dhe financiare

janë:

1. Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe e Tregtisë
2. Ministria e Financave

Nga Pala Shqiptare, koordinimi i përgjithshëm për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të sigurohet nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë.

Kërkesa nga Qeveria Shqiptare për asistencë do të transmetohet nga zyra e koordinatorit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Tiranë, në zyrat kompetente në Zvicër. Agjencia kryesore për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) do të sigurojë gjithashtu lidhjen midis autoriteteve shqiptare dhe zvicerane për zbatimin dhe monitorimin e projekteve.

7.3 Ndihma Zvicerane e emergjencës dhe humanitare sillet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

7.4 Bazuar në këtë Marrëveshje, çdo projekt do të jetë subjekt i një Marrëveshjeje të veçantë, ndërmjet partnerëve të projektit, duke stimuluar dhe përcaktuar të drejtat dhe detyrimet që do të lindin nga secili partner i projektit.

7.5 Në mënyrë që të shmangen duplikimet me projekte të zbatuara nga donatorë të tjerë dhe të jemi të sigurt që projektet do të kenë efektin më të madh të mundshëm, dy Qeveritë do të bëjnë të mundur përdorimin e të gjitha mjeteve për një koordinim sa më efektiv të asistencës ndërkombëtare.

7.6 Qeveritë do të kenë, secila, një informacion të plotë mbi projektet e ndërmarra nën këtë Marrëveshje. Ato do të shkëmbejnë pikëpamje dhe do të takohen periodikisht, sipas marrëveshjes së përbashkët, për të diskutuar dhe vlerësuar bashkëpunimin teknik dhe financiar të programeve dhe të marrin masat e nevojshme për përmirësime. Në këto raste, të dy Qeveritë mund të sugjerojnë ndryshime në zonat e bashkëpunimit, të përmendura më sipër dhe/ose procedurave, duke pasur parasysh rezultatet e vlerësimit.

## Neni 8

### **Modifikimet dhe Rregullimi i Mosmarrëveshjeve**

8.1 Çdo modifikim ose ndryshim në Marrëveshjen prezente do të bëhet me shkrim me pëlqimin e të dy Qeverive.

8.2 Çdo mosmarrëveshje që del nga kjo Marrëveshje do të futet nëpërmjet bisedimeve diplomatike.

## Neni 9

### **Kohëzgjatja**

9.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e shkëmbimit të njoftimeve të fundit të konfirmimit dhe kompletimit nga të dy Qeveritë të procedurave të tyre të brendshme, të nevojshme për këtë hyrje në fuqi. Kjo Marrëveshje do të aplikohet në baza kohore, ndërmjet firmosjes bazuar në legjisllacionin e brendshëm të dy vendeve. Marrëveshja do të qëndrojë në fuqi për 5 vjet. Pas kësaj periudhe do të rinovohet për një periudhë tjetër 5 -vjeçare, me anë të shkëmbimit të letrave.

Në rast shkeljeje të rëndë të çdo elementi themelor ose objektivi, të cilëve u referohet Neni 1 dhe Neni 2, secila Qeveri do të ketë të drejtën e ndërprerjes ose përfundimit me njoftim të shkruar të çdo Marrëveshjeje të veçantë, të cilave u referohet Neni 6.1 dhe Neni 7.5 me efekt të menjëhershëm. Përpara se të bëjë këtë veprim, Qeveria e cila e ndërmerr këtë masë duhet t'i sjellë Qeverisë tjetër informacionin e nevojshëm për një ekzaminim të hollësishëm të situatës, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje.

9.2 Në rast përfundimi të Marrëveshjes aktuale në Nenin 9.1, kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të aplikohen për të gjitha projektet, për të cilat është rënë dakort para përfundimit të saj.

Bërë në dy origjinale, në Tiranë më 20 shkurt 2001, në gjuhët Angleze dhe Shqipe, të dy tekstet janë autentikisht të njëjtë. Në rast mospërputhjeje në interpretim midis gjuhës Angleze dhe Shqipe, do të jetë i vlefshëm teksti në Anglisht.

Për Qeverinë e Konfederatës Zvicerane

Për Qeverinë e Shqipërisë

Z. Walter Fust  
Drejtori i Përgjithshëm i SDC

Znj. Ermelinda Meksi  
Ministre e Bashkëpunimit Ekonomik dhe  
Tregtisë

**L I G J**  
**Nr.8778, datë 26.4.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS PENALE PËR KORRUPSIONIN”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

**Neni 1**

Ratifikohet “Konventa penale për korrupsionin”, bërë në Strasburg më 27.1.1999, me rezervat e parashikuara në këtë ligj.

**Neni 2**

Në mbështetje të nenit 37 të Konventës, Shteti Shqiptar shpreh këto rezerva:

1. Të rezervojë të drejtën e vet për të mos vendosur si vepra penale, sipas ligjit të tij kombëtar, pjesërisht ose tërësisht, sjellje të referuara në nenet 4, 6 deri në 8, 10 deri në 12 ose të veprave të korrupsionit pasiv, të përcaktuara në nenin 5 të Konventës (neni 37/1).

2. Të deklarojë përdorimin prej Shtetit Shqiptar të rezervës së parashikuar në nenin 17/2 të Konventës (37/2).

3. Të deklarojë se mund të refuzojë asistencën e ndërsjellë ligjore, sipas nenit 26/1 të Konventës, nëse kërkesa lidhet me një vepër penale që nga Shteti Shqiptar vlerësohet si vepër politike (neni 37/3).

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2999, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës  
Rexhep Meidani**

**KONVENTA PENALE PËR KORRUPSION**

Strasburg, më 21.1.1999  
Seria e traktateve europiane / 173

**HYRJE**

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese si vijon:

Duke marrë në konsideratë se qëllimi i Këshillit të Europës është të mbështesë një unitet të madh midis anëtarëve të tij;

Duke njohur vlerën e përkrahjes së bashkëpunimit me shtete të tjera nënshkruese të kësaj Konvente;

Të bindur në nevojën e ndjekjes, si një çështje e prioritetit të një politike penale të përbashkët, duke u mbështetur në mbrojtjen e shoqërisë nga korrupsioni, përfshirë përshtatjen e legjislacionit të përshtatshëm dhe masave parandaluese;

Duke theksuar se korrupsioni dëmton shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, ul nivelin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe drejtësisë shoqërore, pengon konkurrencën, zhvillimin ekonomik dhe rrezikon qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike dhe themeleve morale të shoqërisë;

Duke besuar se një luftë efektive ndaj korrupsionit kërkon bashkëpunim ndërkombëtar të gjerë, të shpejtë dhe mirëfunksionues në çështjet penale;

Duke mirëpritur zhvillimet më të fundit, të cilat avancojnë marrëveshjet dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit, përfshirë veprime të kombeve të Bashkuara, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, Organizatën Botërore të Tregtisë, Organizatën e Shteteve Amerikane, Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe Bashkimin Europian;

Duke patur parasysh Programin e Veprimit kundër Korrupsionit, të miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në nëntor 1996, sipas rekomandimeve të Konferencës së 19-të të Ministrave Europianë të Drejtësisë (Valeta, 1994);

Duke treguar rëndësinë e pjesëmarrjes së shteteve joanëtare në veprimtaritë e Këshillit të Europës kundër korrupsionit dhe duke mirëpritur kontributin e tyre të çmuar në zbatimin e Programit të Veprimit kundër Korrupsionit;

Duke treguar se Rezoluta nr.1, e miratuar nga Ministrat europianë të drejtësisë në konferencën e tyre të 21-të (Pragë, 1997), rekomandonte zbatimin e shpejtë të Programit të Veprimit kundër Korrupsionit dhe bënte thirrje, veçanërisht, për miratimin e shpejtë të konventës penale, duke parashikuar ndërshkrimin e koordinuar të veprave të korrupsionit, përkrahur bashkëpunimin për procedimin e këtyre veprave, sikurse dhe një mekanizëm pasues efektiv, të hapur për shtetet anëtare dhe joanëtare mbi baza barazie;

Duke patur parasysh se kërret e shteteve dhe Qeverive të Këshillit të Europës vendosën, me rastin e samitit të tyre të dytë të mbajtur në Strasburg me 10 dhe 11 tetor 1997, të japin përgjigje të përbashkëta për ndryshimet e ndodhura nga rritja e korrupsionit dhe miratuan një plan veprimi, i cili me qëllim përkrahjen e bashkëpunimit në luftën kundër korrupsionit, përfshirë lidhjet e tij me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, instruktuan Komitetin e Ministrave, inter alia, të sigurojë plotësimin e shpejtë të instrumenteve ligjorë ndërkombëtarë, mbi bazën e Programit të Veprimit kundër Korrupsionit;

Duke konsideruar se rezoluta (97) 24 në 20 Parimet Drejtuese për luftën kundër korrupsionit, miratuar në 6 nëntor 1997 nga Komiteti i Ministrave në sesionin e tij të 101-të, nënvizoi nevojën e plotësimit të shpejtë të përpunimit të instrumenteve ligjore ndërkombëtarë, mbi bazën e Programit të Veprimit kundër Korrupsionit;

Në vështrimin e miratimit nga Komiteti i Ministrave në sesionin e tij të 102-të të datës 4 maj 1998, të rezolutës (98) 7 e cila autorizon marrëveshjen e pjesshme dhe të gjerë krijuese të “Grupit të shteteve kundër korrupsionit –CRECO”, e cila ka për qëllim përmirësimin e kapacitetit të anëtarëve të saj, për të luftuar korrupsionin nëpërmjet kryerjes së përputhshmërisë me angazhimet e tyre në këtë fushë;

Kanë pranuar si vijon:

## KREU I PËRDORIMI I TERMAVE

### Neni 1 Përdorimi i termave

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) “Zyrtar publik” do të kuptohet në referencë me përkufizimin e “zyrtar” “oficer publik”, “kryebashkiak”, “ministër”, ose “gjyqtar”, në ligjin kombëtar të shtetit në të cilin personi në fjalë ushtron funksion dhe sikurse zbatohet në ligjin e tij penal;

b) termi “gjyqtar” i referohet paragrafit të mësipërm “a” dhe përfshin prokurorët dhe mbajtësit e shërbimeve gjyqësore;

c) në rastin e procedimeve që përfshijnë një zyrtar publik të një shteti tjetër, shteti procedues mund të zbatojë përkufizimin e zyrtarit publik, vetëm në rast se ky përkufizim përputhet me ligjin e tij kombëtar”;

d) “Person juridik” do të kuptohet çdo entitet që ka këtë status, sipas ligjit kombëtar të zbatueshëm, përveçse për shtete ose trupa të tjerë publikë në ushtrim të autoritetit shtetëror dhe për organizata ndërkombëtare publike.

## KREU II MASA QË DUHET TË MERREN NË NIVELIN KOMBËTAR

### Neni 2 Korrupsioni aktiv i zyrtarëve publikë kombëtarë

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt të çfarëdoqavantazhi, që nuk i takon cilitdo zyrtari publik të asaj Pale, për vete ose për dikë tjetër, ndaj tij/saj, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.

### Neni 3 Korrupsioni pasiv i zyrtarëve publikë kombëtarë

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim kërkimin ose marrjen nga cilido prej zyrtarëve publikë të asaj Pale, direkt ose indirekt, të çfarëdoqavantazhi që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimi i një oferte ose premtimi apo avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj.

### Neni 4 Korrupsioni i anëtarëve të asambleve publike kombëtare

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido person që është anëtar i çfarëdo asambleje kombëtare publike, që ushtron pushtete legislative ose administrative.

### Neni 5 Korrupsioni i zyrtarëve publikë të huaj

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet ndonjë zyrtar publik i një shteti tjetër.

#### Neni 6

### **Korrupsioni i anëtarëve të asambleve publike të huaja**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido person që është anëtar i çfardo asambleje publike, që ushtron pushtete legislative ose administrative në një shtet tjetër.

#### Neni 7

### **Korrupsioni aktiv në sektorin privat**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesit) premtimin, ofrimin ose dhënien direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon, cilitdo personi që drejton ose punon, në çfarëdo cilësie, në entitete të sektorit privat, për vete apo për të tjerë që ata të veprojnë ose të mosveprojnë, në kundërshtim me detyrat e tyre.

#### Neni 8

### **Korrupsioni pasiv në sektorin privat**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale, sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim gjatë veprimtarisë ekonomike (biznesit), kërkimin ose marrjen, direkt ose indirekt, nga cilido person që drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, në entitete të sektorit privat, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon ose premtimi për vete apo për të tjerë, ose pranimi i një oferte apo premtimi i një avantazhi të tillë, për të vepruar ose mosvepruar në kundërshtim me detyrat e tyre.

#### Neni 9

### **Korrupsioni i zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido zyrtar apo i punësuar me kontratë, në përputhje me kuptimin e rregullave të personelit, të çdo organizate publike ndërkombëtare ose mbikombëtare ose trupe ku Pala është anëtare, si edhe çdo person tjetër, që ushtron funksione që i korrespondojnë atyre të ushtruara nga zyrtarë apo agjentë të tillë.

#### Neni 10

### **Korrupsioni i anëtarëve të asambleve parlamentare ndërkombëtare**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenin 4 kur përfshihet cilido anëtar i asambleve parlamentare të organizatave ndërkombëtare apo mbikombëtare ku Pala është anëtare.

#### Neni 11

### **Korrupsioni i gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera që janë të nevojshme për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në nenet 2 dhe 3, kur përfshihet cilido mbajtës i zyrave gjyqësore ose zyrtarë të gjykatave ndërkombëtare, juridiksioni i të cilave është pranuar nga Pala.

Neni 12  
**Ushtrimi i ndikimit**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, kur kryhen me qëllim premtimin, dhënien ose ofrimin, direkt ose indirekt, të çfarëdolloj avantazhi që nuk i takon cilitdo që siguron ose konfirmon se është i aftë të ushtrojë ndikim në vendimmarrjen e cilitdo personi të referuar në nenet 2, 4, 5, 6, 9, 10, 11, në përputhje me këtë dispozitë, kur avantazhi që nuk i takon është për atë vetë apo për të tjerë, sikurse dhe kërkimi, marrja ose pranimi i ofertës ose premtimi i një avantazhi të tilë, në përputhje me këtë ndikim, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose jo ose pavarësisht nëse ndikimi i supozuar çon ose jo në rezultatin e synuar.

Neni 13  
**Pastrimi i parave të produkteve nga veprat e korrupsionit**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative, dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, sjelljen e referuar në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit (Seria e trakteteve europiane nr.141) neni 6 paragrafet 1 dhe 2, sipas kushteve të referuara aty, kur vepra e treguar konsiston në një nga veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 12 të kësaj konvente, në rastin kur Pala nuk ka bërë rezervime apo deklarime, lidhur me këto vepra ose nuk i konsideron këto vepra si serioze për qëllimin e legjislacionit të saj për pastrimin e parave.

Neni 14  
**Veprat e llogarive**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra që dënohen me sanksione penale apo të tjera, sipas legjislacionit të saj kombëtar veprimet ose mungesat vijuese, të kryera me qëllim për të kryer, fshehur ose maskuar veprat e referuara në nenet 2 deri 12, në rastin kur Pala nuk ka bërë rezervime ose deklarime:

- a) duke krijuar ose shfrytëzuar një faturë ose dokument tjetër llogarie ose regjistrim që përmban informacion fals ose jo të plotë;
- b) boshllëqe të paligjshme për bërjen e një regjistrimi të një pagese.

Neni 15  
**Akte pjesëmarrëse**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për përcaktimin si vepra penale sipas legjislacionit të saj kombëtar, dhënien e ndihmës ose përkrahjen e kryerjes së këtyre veprave penale, të vendosura në përputhje me këtë konventë.

Neni 16  
**Imuniteti**

Parashikimet e kësaj konvente nuk paragjykojnë parashikimet e asnjëlloj traktati, protokollit ose statuti, sikurse dhe tekstet e tyre zbatuese, përsa i përket heqjes së imunitetit.

Neni 17  
**Juridiksioni**

1. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për vendosjen e juridiksionit mbi vepra penale, të vendosur në përputhje me nenet 2 deri 14 të kësaj konvente kur:

a) vepra është kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj;  
b) autori i veprës është shtetas i saj, zyrtar publik i saj ose anëtar i asambleve publike kombëtare të saj;

c) vepra përfshin një nga zyrtarët e saj publikë, ose anëtarët e asambleve publike kombëtare të saj, ose çdo person, referuar neneve 9 deri 11, i cili është në të njëjtën kohë shtetas i saj.

2. Çdo shtet mundet që, në momentin e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të deklarojë me anë të një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës se ai rezervon të drejtën për të mos zbatuar ose për të zbatuar vetëm, në raste ose kushte specifike, rregullat juridiksionale, të parashikuara në paragrafin 1 “b” dhe “c” të këtij neni ose një pjesë të tyre.

3. Nëse një Palë e ka përdorur rezervimin e parashikuar mundësisht në paragrafin 2 të këtij neni, ajo duhet të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme për vendosjen e juridiksionit mbi një vepër penale të vendosur në përputhje me këtë konventë, në rastet kur autori përkatës ndodhet në territorin e saj dhe nuk mund të ekstradohet te një Palë tjetër, vetëm në bazë të shtetësisë së tij, pas kërkesës për ekstradim.

4. Kjo konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar nga ndonjë Palë, në përputhje me ligjin kombëtar.

#### Neni 18

### **Përgjegjësia e personave juridike**

1. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera që janë të nevojshme, për të siguruar që personat juridikë mund të përgjigjen për veprat penale të korrupsionit aktiv, ushtrimit të ndikimit dhe pastrimit të parave të vendosura në përputhje me këtë konventë, të kryera për përfitimin e tyre nga persona fizikë, që veprojnë ose individualisht, ose si pjesë e një organi të personit juridik, e që kanë pozicione drejtuese brenda personit juridik, bazuar në:

- pushtet paraqitjeje të personit juridik; ose
- një autoritet që merr vendime për personin juridik; ose
- një autoritet që ushtron kontroll brenda personit juridik;

sikurse dhe për përfshirjen e një personi fizik të tillë si aksesor ose shtesë në veprat e sipërpërmendura.

2. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin 1, secila Palë do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që një person juridik mund të përgjigjet kur mungesa e supervizimit ose kontrollit nga një person fizik, referuar në paragrafin 1, ka bërë të mundur kryerjen e veprave penale të përmendura në paragrafin 1 për përfitimin e atij personi juridik nga një person fizik nën autoritetin e tij.

3. Përgjegjësia e një personi juridik sipas paragrafeve 1 dhe 2, nuk përjashton procedimet penale në ngarkim të personave fizikë që janë kryerës, shtytës ose aksesorë në veprat penale të përmendura në paragrafin 1.

#### Neni 19

### **Sanksione dhe masa**

1. Duke pasur parasysh natyrën serioze të veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë, secila Palë do të sigurojë, në kuptim të këtyre veprave penale, të vendosura në përputhje me nenet 2 deri 14, sanksione dhe masa efektive, proporcionale dhe shtrënguese, përfshirë kur janë kryer nga persona fizikë edhe dënime që përfshijnë heqjen e lirisë, e cila mund të japë shkas për ekstradim.

2. Secila Palë do të sigurojë që personat juridikë që kanë përgjegjësi, në përputhje me nenin 18 paragrafet 1 dhe 2, do të jenë subjekte të sanksioneve penale ose jopenale efektive, proporcionale dhe shtrënguese, përfshirë edhe sanksione monetare.

3. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legjislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për ta bërë atë të aftë të konfiskojë apo marrë mjetet dhe produktet e veprave penale, të vendosura në përputhje me këtë konventë, ose prona, vlera e të cilave i korrespondon këtyre produkteve.



Neni 20  
**Autoritete të specializuara**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera që janë të nevojshme, për të siguruar që personat ose entitetet janë të specializuar në luftën kundër korrupsionit. Ata do të kenë pavarësinë e nevojshme, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor të Palës, me qëllim që ata të jenë të aftë të ushtrojnë funksionet e tyre me efektivitet dhe të lirë nga çdo presion i palejuar. Pala do të sigurojë që personeli i këtyre entiteteve ka trajnim dhe burime financiare të përshtatshme për detyrat e tyre.

Neni 21  
**Bashkëpunimi me dhe midis autoriteteve kombëtare**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme, për të siguruar që autoritetet publike, sikurse dhe çdo zyrtar publik bashkëpunon, në përputhje me ligjin kombëtar, me ata të autoriteteve përgjegjëse për hartimin dhe procedimin e veprave penale:

- a) nëpërmjet informimit të këtyre të fundit, me iniciativën e tyre kur ka dyshime të arsyeshme për të besuar se ndonjëra nga veprat penale, të vendosura në përputhje me nenet 2 deri 14 është kryer; ose
- b) duke i siguruar, sipas kërkesës, autoriteteve të fundit gjithë informacionin e nevojshëm.

Neni 22  
**Mbrojtja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe dëshmitarëve**

Secila Palë do të miratojë masa të tilla, që janë të nevojshme, për të siguruar mbrojtje efektive dhe të përshtatshme për:

- a) ata që raportojnë veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 14 ose që bashkëpunojnë me autoritetet hetimore ose proceduese;
- b) dëshmitarë që dëshmojnë lidhur me këto vepra.

Neni 23  
**Masa për lehtësimin e marrjes së evidencave dhe konfiskimin e produkteve**

1. Secila Palë do të miratojë masa legislative dhe të tjera, të tilla që janë të nevojshme, përfshirë dhe ato që mundësojnë përdorimin e teknikave speciale hetimore, në përputhje me ligjin kombëtar, për mundësimin e lehtësimit të marrjes së evidencave, lidhur me veprat penale të vendosura, në përputhje me nenet 2 deri 14 të kësaj konvente dhe të identifikimit, gjurmimit, ndalimit dhe marrjes së mjeteve dhe produkteve të korrupsionit ose pasurive, vlera e të cilave i korrespondon këtyre produkteve, të lidhura këto me masat e vendosura, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 19 të kësaj konvente.

2. Secila Palë do të miratojë masa të tilla legislative dhe të tjera, që janë të nevojshme, për të autorizuar gjykatat e saj ose autoritete të tjera kompetente që të urdhërojnë vënien në dispozicion ose marrjen e regjistrimeve bankare, financiare ose tregtare, me qëllim përmbushjen e veprimeve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Sekretet bankar nuk mund të jetë pengesë për masat e parashikuara në paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni.

KREU III  
MONITORIMI I ZBATIMIT

Neni 24  
**Monitorimi**

Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GRECO) monitoron zbatimin e kësaj konvente nga Palët.

KREU IV  
BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 25

**Parime të përgjithshme dhe masa për bashkëpunimin ndërkombëtar**

1. Palët bashkëpunojnë me njera-tjetrën, në përputhje me parashikimet e instrumenteve ndërkombëtare përkatës të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën penale, ose marrëveshjeve të arritura mbi bazë legjislacioni uniform ose reciprok, dhe në përputhje me ligjin e tyre kombëtar, në kuptimin më të gjerë të mundshëm, për qëllimet e hetimit dhe procedimit që i përkasin veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë.

2. Kur nuk ka instrumente ndërkombëtare ose marrëveshje në fuqi midis Palëve, të referuara në paragrafin 1, zbatohen nenet 26 deri 31 të këtij kreu.

3. Nenet 26 deri 31 të këtij kreu zbatohen edhe kur ato janë me favorizuese sesa dispozitat e instrumenteve ndërkombëtare ose marrëveshjeve të referuara në paragrafin 1.

Neni 26

**Asistenca e ndërsjellë**

1. Palët i ofrojnë njera-tjetrës masat më të gjera të asistencës së ndërsjellë, nëpërmjet procedimit të shpejtë të kërkesave nga autoritetet që, në përputhje me ligjet e tyre kombëtare, kanë të drejtën e hetimit ose procedimit të veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë.

2. Asistenca e ndërsjellë ligjore, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të refuzohet nëse Pala e kërkuar beson se kërkesa e bërë dëmton interesat e saj themelore, sovranitetin kombëtar, sigurinë kombëtare ose rendin publik.

3. Palët nuk do të përdorin sekretin bankar si arsye për refuzimin e çfarëdo bashkëpunimi, sipas këtij kreu. Në rast se ligji kombëtar e kërkon, Pala mund të kërkojë që kërkesa për bashkëpunim, e cila përfshin zbulimin e sekretit bankar, të autorizohet ose nga një gjyqtar, ose nga një autoritet tjetër gjyqësor, përfshirë prokurorët publikë, ndonjë nga këto autoritete që veprojnë lidhur me veprat penale.

Neni 27

**Ekstradimi**

1. Veprat penale të vendosura në përputhje me këtë konventë konsiderohen se përfshihen si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi, që ekziston midis ose ndërmjet Palëve. Palët marrin përsipër të përfshijnë këto vepra si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që do të lidhet midis ose ndërmjet tyre.

2. Nëse një Palë, që kryen ekstradim të kushtëzuar mbi bazën e eksistencës së një traktari, merr një kërkesë për ekstradim nga një Palë tjetër me të cilën nuk ka ndonjë traktat ekstradimi, mund ta konsiderojë këtë konventë si një bazë ligjore për ekstradim, në kuptim të çdo veprave penale, të vendosur në përputhje me këtë konventë.

3. Palët, që nuk kryejnë ekstradim të kushtëzuar nga ekzistenca e një traktati, njohin veprat penale të vendosura në përputhje me këtë konventë si vepra të ekstradueshme midis tyre.

4. Ekstradimi i nënshtrohet kushteve të parashikuara në ligjet e Palës së kërkuar ose në traktatet e zbatueshme të ekstradimit, përfshirë arsyet për të cilat Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin.

5. Nëse ekstradimi për një veprën penale të vendosur në përputhje me këtë konventë refuzohet vetëm mbi bazën e shtetësisë së personit të kërkuar, ose për shkak se pala e kërkuar konsideron se ka juridiksion mbi veprën, Pala e kërkuar ia paraqet çështjen autoriteteve të saj kompetente për qëllimet e procedimit, përderisa nuk është rënë dakord ndryshe me Palën kërkuuese, dhe do t'i raportojë rezultatin përfundimtar Palës kërkuuese në të njëjtën rrugë.

#### Neni 28

#### **Informacioni i rastësishëm**

Pa paragjykuar hetimet ose procedimet e veta, një Palë mundet t'i japë një Pale tjetër pa patur kërkesë nga kjo, informacion për fakte kur ajo konsideron se dhënia e këtij informacioni mund të asistojë Palën marrëse në fillimin ose ushtrimin e hetimeve ose procedimeve që i përkasin veprave penale të vendosura në përputhje me këtë konventë ose mund të çojnë në një kërkesë nga ajo Palë, sipas këtij kreu.

#### Neni 29

#### **Autoriteti qendror**

1. Palët caktojnë një autoritet qendror ose, nëse është e përshtatshme, autoritete qendrore të ndryshme, të cilat janë përgjegjëse për dërgimin dhe përgjigjen e kërkesave të bëra sipas këtij kreu, ekzekutimin e këtyre kërkesave ose transmetimin e tyre tek autoritetet kompetente për ekzekutimin e tyre.

2. Secila Palë i komunikon Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, emrat dhe adresat e autoriteteve të treguara, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 30

#### **Komunikimi i drejtpërdrejtë**

1. Autoritetet qendrore komunikojnë drejtpërdrejt midis tyre.

2. Në rast urgjence, kërkesat për asistencë të ndërsjellë ose komunikimet që lidhen me to mund të dërgohen direkt nga autoritetet gjyqësore, përfshirë prokurorët publikë të Palës kërkuuese tek autoritete të tilla të Palës së kërkuar. Në raste të tilla, i dërgohet në të njëjtën kohë një kopje autoritetit qendror të Palës së kërkuar nëpërmjet autoritetit qendror të Palës kërkuuese.

3. Çdo kërkesë ose komunikim, sipas paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni, mund të bëhet nëpërmjet Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL).

4. Kur, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni është bërë një kërkesë dhe autoriteti nuk është kompetent të trajtojë kërkesën, ai i referon kërkesën autoritetit kompetent kombëtar dhe informon direkt Palën kërkuuese përsa ka vepruar.

5. Kërkesat ose komunikimet, sipas paragrafit 2 të këtij neni që nuk përfshijnë veprime detyruese, mund t'u transmetohen direkt nga autoritetet kompetente të Palës kërkuuese autoriteteve kompetente të Palës së kërkuar.

6. Secili shtet mund të informojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, se për arsye të efektivitetit, kërkesat e bëra sipas këtij kreu duhet t'i adresohen autoritetit të tij qendror.

Neni 31  
Informacioni

Pala e kërkuar informon menjëherë Palën kërkuuese për veprimin e ndërmarrë për një kërkesë sipas këtij kreu dhe rezultatit përfundimtar të këtij veprimi. Pala e kërkuar informon, gjithashtu, menjëherë Palën kërkuuese për çdo rrethanë që e bën të pamundur përmbushjen e veprimit në fjalë ose që e vonojnë atë ndjeshëm.

**KREU V**  
**PARASHIKIME PËRFUNDIMTARE**

Neni 32  
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe nga shtete joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj.

Këto shtete mund ta shprehin pëlqimin e tyre për t'u bërë Palë nëpërmjet:

- a) nënshkrimit pa rezerva dhe ratifikimit, pranimit ose miratimi; ose
- b) nënshkrimit me qëllim ratifikimi, pranimi ose miratimi të pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës, në të cilën katërmbëdhjetë shtete kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë Palë në konventë në përputhje me parashikimet e paragrafit 1. Çdo shtet që nuk është anëtar i Grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO) në momentin e ratifikimit, bëhet automatikisht anëtar në datën kur Konventa hyn në fuqi.

4. Për shtetet nënshkruese, që bëhen Palë në këtë konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën ata kanë shprehur pëlqimin e tyre për të qenë Palë në konventë, në përputhje me parashikimet e paragrafit 1ssss. Çdo shtet nënshkrues, që nuk është anëtar i Grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO) në momentin e ratifikimit, bëhet automatikisht anëtar në datën kur Konventa hyn në fuqi për të.

Neni 33  
**Aderimi në konventë**

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit të shteteve Palë të konventës mund të ftojë Komunitetin European, sikurse dhe çdo shtet joanëtar të Këshillit dhe që nuk ka marrë pjesë në hartimin e saj, të aderojë në këtë konventë nëpërmjet një vendimi të marrë me shumicën e parashikuar në nenin 20 "d" të Statutit të Këshillit të Europës dhe duhet të marrë miratimin unanimit të përfaqësuesve të shteteve Palë që kanë të drejtë pjesëmarrjeje në Komitetin e Ministrave.

2. Lidhur me Komunitetin European, sikurse dhe çdo shtet që aderon në të, sipas paragrafit 1 të mësipërm, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën është depozituar instrumenti i aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Komuniteti European dhe çdo shtet që aderon në konventë bëhet automatikisht anëtar i GRECO-s, nëse nuk është trashmë anëtar në momentin e aderimit, në datën kur Konventa hyn në fuqi për të.

Neni 34  
**Zbatimi territorial**

1. Çdo shtet kontraktues mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të specifikojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo konventë.

2. Çdo Palë mundet, në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj konvente në cilindo territor ose territore të specifikuar në deklaratë. Lidhur me këtë territor, konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën është marrë kjo deklaratë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë, e bërë në përputhje me dy paragrafet e mësipërm, mundet, lidhur me ato territore të treguara në atë deklaratë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja bëhet efektive ditën e parë të muajit që pason tre muaj pas datës në të cilën është marrë njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

#### Neni 35

### **Raporti me konventat dhe marrëveshjet e tjera**

1. Kjo Konventë nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga konventa ndërkombëtare shumëpalëshe, që përmbajnë fusha speciale.

2. Shtetet Palë në konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe mes tyre lidhur me çështjet e rregulluara nga kjo konventë për të plotësuar ose forcuar parashikimet e saj ose për të lehtësuar zbatimin e parimeve që përmbahen aty.

3. Nëse dy ose më shumë Palë kanë përfunduar tashmë një marrëveshje ose traktat, lidhur me një subjekt që trajtohet nga kjo konventë ose kanë vendosur në një mënyrë tjetër raportet e tyre lidhur me atë subjekt, ata do të kenë të drejtë të zbatojnë atë marrëveshje apo traktat, ose t'i rregullojnë ato marrëdhënie, në frymën e kësaj Konvente, nëse lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar.

#### Neni 36

### **Deklarime**

Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë përdorimin prej tij si vepra penale korrupsionin aktiv dhe pasiv të zyrtarëve publikë të huaj sipas nenit 5, të zyrtarëve të organizatave ndërkombëtare sipas nenit 9 ose të gjyqtarëve dhe zyrtarëve të gjykatave ndërkombëtare sipas nenin 11, vetëm në rastin kur gjyqtari apo zyrtari publik vepron ose nuk vepron në kundërshtim me detyrat e tij.

#### Neni 37

### **Rezerva**

1. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të rezervojë të drejtën e tij për të mos vendosur si vepra penale sipas ligjit të tij kombëtar, pjesërisht ose tërësisht, sjelljet e referuara në nenet 4, 6 deri 8, 10 deri 12 ose të veprave të korrupsionit pasiv të përcaktuara në nenin 5.

2. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë përdorimin prej tij të rezervës së parashikuar në nenin 17 paragrafi 2.

3. Çdo shtet mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të deklarojë se mund të refuzojë asistencën e ndërsjellë ligjore sipas nenit 26 paragrafi 1, nëse kërkesa lidhet me një vepër që konsiderohet nga Pala e kërkuar si vepër politike .

4. Asnjë shtet nuk mund të bëjë, sipas zbatimit të paragrafeve 1, 2 dhe 3 të këtij neni, rezerva për më shumë se sa pesë nga parashikimet e përmendura këtu. Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet. Rezervat e të njëjtës natyrë sipas neneve 4, 6 dhe 10 do të konsiderohen si një rezervë.

## Neni 38

### **Vlefshmëria dhe rishikimi i deklarimeve dhe rezervave**

1. Deklarimet e referuara në nenin 36 dhe rezervat e referuara në nenin 37 janë të vlefshme për një periudhë prej tre vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të konventës për shtetin përkatës. Sidoqoftë, këto deklarime dhe rezerva mund të rinovohen për periudha së të njëjtës gjatësi.

2. Dy muaj para datës së skadimit të deklarimit ose rezervës, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton për skadimin shtetin përkatës. Jo më vonë se tre muaj para skadimit, shteti njofton Sekretarin e Përgjithshëm se ai do ta mbajë, ndryshojë ose tërheqë deklarimin ose rezervën e tij. Në mungesë të njoftimit nga shteti përkatës, Sekretari i Përgjithshëm informon atë shtet se deklarimi ose rezerva e tij konsiderohet se është shtrirë automatikisht për një periudhë prej gjashtë muajsh. Nëse shteti përkatës nuk njofton qëllimin e tij, për të mbajtur ose ndryshuar deklarimin ose rezervën e tij para skadimit të kësaj periudhe, kjo sjell humbjen e deklarimit ose të rezervës.

3. Nëse një Palë bën një deklaram ose rezervë në përputhje me nenet 36 dhe 37, ajo duhet të bëjë para rinovimit të saj ose bërjes së kërkesës, një shpjegim ndaj GRECO-s për arsyet që justifikojnë vazhdimin e tij/saj.

## Neni 39

### **Ndryshimet**

1. Ndryshime të kësaj konvente mund të propozohen nga çdo Palë dhe do t'i komunikohen nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës shteteve anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shteti joanëtar që ka aderuar në konventë ose është ftuar të aderojë në përputhje me parashikimet e nenit 33.

2. Çdo ndryshim i propozuar nga një Palë do t'i komunikohet Komitetit European për Problemet Penale (CDPC) që do t'i paraqesë Komitetit të Ministrave mendimin e tij për ndryshimin e propozuar.

3. Komiteti i Ministrave e konsideron ndryshimin e propozuar dhe mendimin e dhënë nga CDPC-ja dhe pas konsultimit me shtetet joanëtare Palë në këtë konventë, mund të miratojë ndryshimin.

4. Teksti i çdo ndryshimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, u jepet Palëve për pranim.

5. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas njoftimit, nga të gjitha Palët, të Sekretarit të Përgjithshëm për pranimin nga ana e tyre të ndryshimit.

## Neni 40

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Komiteti European për Problemet Penale i Këshillit të Europës mbahet i informuar lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj konvente.

2. Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet Palëve për interpretimin ose zbatimin e kësaj konvente, ato duhet të gjejnë zgjidhje të mosmarrëveshjes nëpërmjet bisedimit ose mjeteve të tjera paqësore të zgjedhjes së tyre, përfshirë paraqitjen e mosmarrëveshjes para Komitetit European për problemet penale, një gjykatë arbitrazhi, vendimi i së cilës do të jetë i detyrueshëm për Palët ose para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sikurse pranohet nga Palët përkatëse.

## Neni 41

### **Denoncimi**

1. Çdo Palë mundet, në çdo kohë, të denoncojë këtë konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të ketë efekt ditën e parë të muajit pasues të skadencës së periudhës prej tre muajsh nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 42  
**Njoftimi**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenet 32 dhe 33 të saj;
- d) çdo deklaratë ose rezervë të bërë në përputhje me nenet 36 ose 37;
- e) çdo veprim tjetër, njoftim ose komunikim lidhur me këtë konventë.

Si dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar si duhet për këtë gjë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Strasburg, më 27 janar 1999, në anglisht dhe frëngjisht të dyja tekstet njëloj të vlefshëm, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet anëtar të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj konvente dhe çdo shtet tjetër të ftuar për aderim në të.

**L I G J**  
**Nr.8779, datë 26.4.2001**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8070, DATË 15.2.1996; NR.8126, DATË 9.7.1996; NR.8130, DATË 22.7.1996; NR.8149, DATË 11.9.1996; NR.8160, DATË 7.11.1996; NR.8166, DATË 23.1.1997; NR.8201, DATË 20.3.1997; NR.8140, DATË 16.9.1997; NR.8445, DATË 21.1.1999 DHE NR.8714, DATË 15.12.2000**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

Neni 1

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995, ndryshuar me ligjet nr.8070, datë 15.2.1996; nr.8126, datë 9.7.1996; nr.8130, datë 22.7.1996; nr.8149, datë 11.9.1996; nr.8160, datë 7.11.1996; nr.8166, datë 23.1.1997; nr.8201, datë 20.3.1997; nr.8140, datë 16.9.1997; nr.8445, datë 21.1.1999 dhe nr.8714, datë 15.12.2000, pas nenit 25/3 shtohet neni 25/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/4

Përfshihen nga tatimi mbi vlerën e shtuar shitja e gazetave dhe e revistave ditore e javore, si dhe shërbimi i reklamave që ato publikojnë për persona të tjerë.”

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3006, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Rexhep Meidani**

**L I G J**  
**Nr.8781, datë 3.5.2001**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7850,  
DATË 29.7.1994 “KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 81 pika 2 shkronja “d” dhe të nenit 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Neni 39 ndryshohet si vijon:

“Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj.”

**Neni 2**

Pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:

“Shoqata ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe me qëllimin e objektin e veprimtarisë së shoqatës, të parashikuar në statutin e saj.

Të ardhurat e realizuara nga shoqata duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e saj.

Nuk lejohet që shoqata të kryejë veprimtari fitimprurëse.”

**Neni 3**

- Në nenin 40, para paragrafit të parë, shtohet ky paragraf:

“Akti për krijimin e shoqatës, me kërkesë të themeluesve të saj, regjistrohet në gjykatë”.

- Fjalja e parë e nenit 40 ndryshohet si vijon:

“Rregullat për organizimin e funksionimin e shoqatës përcaktohen në statutin e saj, i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të përmbajë sidomos:”



#### Neni 4

Në nenin 41, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Shoqata themelohet nga mbledhja e themeluesve, në të cilën miratohet statuti dhe zgjidhen organet drejtuese të saj. Shoqata, me kërkesën e saj, regjistrohet në gjykatë sipas mënyrës së parashikuar në ligj.”

#### Neni 5

Neni 42 ndryshohet si vijon:

“Shoqata fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e saj.”

#### Neni 6

Neni 43 ndryshohet si vijon:

“Shoqata ka të drejtë të themelojë degë të saj kudo ku ajo e çmon të arsyeshme, për të realizuar qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqatës.”

#### Neni 7

Pas nenit 43 shtohet neni 43/1 me këtë përmbajtje:

“Rastet dhe mënyrat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqatave nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj.”

#### Neni 8

Në nenin 46, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Anëtari i shoqatës nuk merr pjesë në diskutim dhe votim në rastet kur vetë ose bashkëshorti, fëmijët, gjinia a krushqia e tij janë në konflikt interesash me shoqatën, lidhur me një çështje të rendit të ditës.

Miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të shoqatës vendimet për ndryshimin e statudit dhe për shpërndarjen e shoqatës, përveç kur në statut parashikohet një shumicë më e lartë votimi.”

#### Neni 9

Në nenin 50, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Anëtari, që largohet ose përjashtohet nga shoqata, përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve deri në çastin e largimit të tij dhe nuk ka të drejta mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj.”

#### Neni 10

Neni 52 riformulohet si vijon:

“Shpërndarja e shoqatës bëhet:

- a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;
- b) kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar në këtë Kod ose në statut;
- c) kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;
- ç) kur vërtetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme;
- d) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

Gjykata, në rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë shpërndarjen e shoqatës, me kërkesë të çdo anëtari të shoqatës, të organeve vendimmarrëse të saj, si dhe të organeve kompetente shtetërore.”

#### Neni 11

Neni 53 ndryshohet si vijon:

“Kur vendoset shpërndarja e shoqatës, ajo vihet në likuidim dhe çregjistrohet sipas rregullave të parashikuara në ligj.”

#### Neni 12

Pas nenit 53 shtohet neni 53/1 si vijon:

“Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e shoqatës, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar shoqata.”

#### Neni 13

Neni 54 ndryshohet si vijon:

“Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut.”

#### Neni 14

Neni 55 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Fondacionet krijohen nga persona fizikë ose juridikë me akt noterial ose me testament. Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesë të themeluesve të tij, regjistrohet në gjykatë.”

#### Neni 15

Neni 56 ndryshohet si vijon:

“Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që nga dita e regjistrimit në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e fondacionit ose ekzekutori i testamentit mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e tij.”

#### Neni 16

Pas nenit 56 shtohet neni 56/1 me këtë përmbajtje:

“Fondacioni ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtmshme dhe të paluajtmshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e objektin e veprimtarive të parashikuara në statutin e fondacionit.

Të ardhurat e realizuara nga fondacioni duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e tij.

Nuk lejohet që fondacioni të kryejë veprimtari fitimprurëse.”

#### Neni 17

Neni 59 ndryshohet si vijon:

“Rastet dhe mënyra e mbikëqyrjes së veprimtarisë së fondacioneve nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj.”

#### Neni 18

Neni 69 shfuqizohet.

## Neni 19

Neni 62 ndryshohet si vijon:

“Shpërndarja e fondacionit bëhet:

- a) me vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij;
  - b) kur është përmbushur qëllimi për të cilin u themelua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;
  - c) kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme;
  - ç) në raste të tjera të parashikuara me ligj.
- Gjykata, në rastet e parashikuara me ligj, mund të vendosë shpërndarjen e fondacionit me kërkesë të çdo themeluesi të tij, të organeve vendimmarrëse të shoqatës, si dhe të organeve kompetente shtetërore.”

## Neni 20

Neni 63 ndryshohet si vijon:

“Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e fondacionit, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së tij, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar fondacioni.”

## Neni 21

Neni 153 ndryshohet si vijon:

“Të drejtat dhe detyrimet e pronarit

Askush nuk mund të shpronësohet ose t'i kufizohet e drejta e ushtrimit të së drejtës të pronës që barazohet me shpronësimin, përveçse kur këtë e kërkojnë interesa publikë dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të drejtë.”

## Neni 22

Në nenin 190, fjalia e parë ndryshohet si vijon:

“Sendet mund të shpronësohen vetëm për interesa publikë të njohur me ligj dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë.”

## Neni 23

Në nenin 361, paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

“Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar në nenin 363 të këtij Kodi dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse, të parashikuar në nenin 364 të këtij Kodi.”

## Neni 24

Në nenin 362, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Fëmijët e lindur jashtë martese, kur atësia ose mëmësia është njohur rregullisht, si dhe fëmijët e birësuar barazohen me fëmijët e lindur nga martesa.”

## Neni 25

Në nenin 398 fjalët “ose sekretari” shfuqizohen.

Neni 26

Në të gjithë Kodin, fjalët “Gjykata e Kasacionit” dhe “gjykata e rrethit” zëvendësohen me fjalët “Gjykata e Lartë” dhe “gjykata e shkallës së parë”.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3003, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Rexhep Meidani**

**D E K R E T**  
**Nr.3018, datë 21.5.2001**

**PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 125 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në pëlqimin e Kuvendit,

**D E K R E T O J :**

Neni 1

Zoti Petrit Pllaçi emërohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**Rexhep Meidani**

**D E K R E T**  
**Nr. 3019, datë 21.5.2001**

**PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 125 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në pëlqimin e Kuvendit,

**D E K R E T O J :**

Neni 1

Zonja Tefta Zaka emërohet anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**Rexhep Meidani**

**D E K R E T**  
**Nr. 3020, datë 21.5.2001**

**PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 125 pika 1 të Kushtetutës, bazuar në pëlqimin e Kuvendit,

**D E K R E T O J:**

Neni 1

Zoti Gjergji Sauli emërohet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**Rexhep Meidani**

**V E N D I M**  
**Nr.291, datë 12.5.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.514, DATË 3.7.1995, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË**  
**ADMINISTRATËS SHTETËRORE, QENDRORE DHE ORGANEVE**  
**TË PUSHTETIT VENDOR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 29 të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Pika 6 e vendimit nr.514, datë 3.7.1995, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë:  
“6. Të gjitha ministratë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor, që hyjnë në lidhje me homologët e tyre jashtë vendit, duhet që, për takimet dhe bisedimet që zhvillojnë, brenda dhe jashtë vendit, me personalitete të huaja, të dërgojnë një relacion në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Këshillin e Ministrave.

Relacioni, i cili dërgohet brenda 15 ditëve nga përfundimi i veprimtarisë, duhet të përmbajë qëllimin dhe objektin e kësaj veprimtarie, të dhëna mbi bisedimet e zhvilluara, analizën e këtyre bisedimeve dhe rekomandimet përkatëse për çëshjet e diskutuara”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr.297, datë 12.5.2001**

**PËR REGJISTRIMIN HIPOTEKOR TË PASURIVE TË SHOQËRIVE  
HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM KUR U MUNGON LEJA E NDËRTIMIT OSE KUR  
OBJEKTI NUK KA PËRFUNDUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr. 8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Regjistrimin nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethet ku ndodhen objektet, në pronësi të shoqërive huamarrëse në administrim, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, të ndërtuara gjatë viteve 1992-1997, pa leje ndërtimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit apo nga KRT-të e rretheve, si dhe kur, megjithëse me leje ndërtimi, objekti nuk ka përfunduar.

2. Administratorët paraqesin pranë KRT-së së rrethit, ku ndodhet objekti, kërkesën për legalizimin e ndërtimit të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi, siç përcaktohet në pikën 1 të vendimit. Kërkesa të shqyrtohet brenda 30 ditëve dhe, përjashtimisht nga rregulli dhe kriteret e caktuara, KRT-ja merr vendimin për legalizimin e ndërtimit.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Grupi Mbikëqyrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, të cilët nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatim, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Illir Meta**

**PASURI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE QË DUHET TË REGJISTROHEN DHE TË PAJISEN  
ME LEJE NDËRTIMI**

Nr	Objektet	Vendndodhja	Shoqëria në administrim	Me ose pa leje ndërtimi
1	Hotel “Lugano”	Tiranë	“M.Leka”	Pa leje ndërtimi
2	Kompleksi i rritjes së derrit	Oshtimë, Vlorë	“Kamberi”	Pa leje ndërtimi
3	Bufe-restorant	Oshtimë, Vlorë	“Kamberi”	Pa leje ndërtimi
4	Thertore	Oshtimë, Vlorë	“Kamberi”	Pa leje ndërtimi
5	Bar-restorant “Dardha”	Tiranë	“Vefa Holding”	Pa leje ndërtimi
6	Qendër biznesi	Vlorë	“Gjallica”	Me leje ndërtimi, por objekt i papërfunduar

**V E N D I M**  
**Nr. 298, datë 12.5.2001**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.37, DATË 21.1.1999 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MBYLLJEN E LLOGARISË SË ISH-FONDACIONIT  
“DEMOKRACIA POPULLORE XHAFERRI” DHE KALIMIN E FONDEVE  
TË MBETURA PËR NDËRTIMIN E APARTAMENTEVE  
PËR KREDITORËT E SKEMAVE PIRAMIDALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të vendimit nr. 37, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e llogarisë së ish-fondacionit “Demokracia Popullore Xhaferri” dhe kalimin e fondeve të mbetura për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Pika 2 e vendimit nr. 37, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave ndryshohet dhe riformulohet si më poshtë vijon:

“Në përfundim të mbylljes së detyrimeve, fondet financiare të mbetura, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të qëndrojnë në Bankën Kombëtare Tregtare, në llogari të veçantë, llogaria për ndërtimin e apartamenteve, për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Illir Meta**

**V E N D I M**  
**Nr. 299, datë 12.5.2001**

**PËR REGJISTRIMIN PËR SHITJE TË SIPËRFAQEVE TË TROJEVE TË OBJEKTEVE NË  
PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Sipërfaqet e trojeve, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilat janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve të qeverisjes vendore e që u janë dhënë me qira shoqërive huamarrëse në administrim, për të realizuar veprimtaritë prodhuese, të regjistrohen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe, sipas autorizimit të lëshuar nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në pronësi të shoqërive huamarrëse në administrim, për shitjen e tyre së bashku me objektin.

2. Shitja e pasurive të shqërive huamarrëse në administrim, të realizohet pranë Qendrës së Ankandave të shtijes publike me tender, në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Vlera e truallit e përcaktuar në lidhjen që i bashkëlidhet këtij vendimi, të derdhet, pas shitjes, në buxhetin e bashkisë ose të komunës.

4. Çmimi për m<sup>2</sup> i sipërfaqes së truallit të jetë 160 lekë për m<sup>2</sup>, siç përcaktohet në pikën 9 të vendimit nr.312, datë 30.6.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për çmimin e truallit që shitet dhe për qiranë e truallit që u jepet në përdorim për ndërtime personave fizikë e juridikë”, ndërsa të

ardhurat që do të përfitohen për shlyerjen e kreditorëve nga shitja e pasurive dhe vlera e tyre përcaktohet në treg, në ankandet e shitjes publike, me tender.

5. Administratorët e shoqërive huamarrëse dhe personat e autorizuar nga kryetari i bashkisë apo i komunës, lidhin për vlerën e truallit që do të derdhet në buxhet marrëveshjet përkatëse për kohën e shlyerjes së vlerave financiare, të përcaktuara në lidhjen që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Pushtetit Lokal, Grupi Mbikëqyrës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Ilir Meta**

**SIPËRFAQET E TROJEVE TË OBJEKTEVE PËR REGJISTRIM NË PRONËSI TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE DHE VLERA E TRUALLIT PËR PAGESË NË BUXHETIN E BASHKISË APO TË KOMUNËS**

Nr.	Objektet	Shoqëria në Administrim	Sipërfaqet e tokës m2	Çmimi i truallit m2	Vlera e truallit në lekë
1	Pularia Yzberisht Tiranë	“Vefa Holding”	16 000	160	2 560 000
2	Kompleksi i derrit Paskuqan, Tiranë	“Vefa Holding”	44 480	160	7 116 800
3	Kombinati i therjes së shpendëve Tiranë	“Vefa Holding”	5 086	160	813 760
4	Kompleksi i shpendeve Paskuqan Tiranë	“Vefa Holding”	36 200	160	5 792 000
5	Kompleksi i gjelit të detit Lushnjë	“Vefa Holding”	16 000	160	2 560 000
6	Pularia Elbasan	“Vefa Holding”	79 800	160	12 768 000
7	Pularia Pukë	“Vefa Holding”	5330	160	852 800
8	Fabrikë vaji Himarë Vlorë	“Vefa Holding”	14 400	160	2 304 000
9	Kompleksi i rritjes së derrit Akerni Vlorë	“Kamberi”	68 800	160	11 008 000
10	Ish merkato nr. 9 Tiranë	“Kamberi”	452	160	72 320
	<b>Totali</b>		<b>257 748</b>	<b>160</b>	<b>41 239 680</b>

**V E N D I M**

**Nr. 300, datë 12.5.2001**

**PËR PAGESËN E VLERËS SË TRUALLIT TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE PËR NDËRTIMIN E APARTAMENTEVE PËR KREDITORET QË KANË HUMBUR BANESAT NGA RËNIA E SKEMAVE PIRAMIDALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes, të ligjit nr. 8386, datë 30.7.1998 “Për mënyrën dhe procedurën e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë” dhe në zbatim të pikës 3 të vendimit nr. 37, datë 21.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për mbylljen e llogarive të ish-fondacionit “Demokracia Popullore Xhaferi” dhe kalimin e fondeve të mbetura për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



## V E N D O S I:

1. Destinacioni i përdorimit të fondeve financiare të mbetura, në Bankën Kombëtare Tregtare, në llogarinë për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, pas rakordimeve dhe shlyerjeve të detyrimeve, që më 31.3.2001, rezulton 324 000 000 (treqind e njetzetë e katër milion) lekë, të jetë:

11 milionë lekë për shlyerjen e detyrimeve ndaj Bankës Kombëtare Tregtare, prej të cilave 6 milionë lekë për rritje detyrimi ndaj kreditorëve, 3 milion lekë për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe 2 milionë lekë fond rezervë, me kusht kthimi.

313 milionë lekë për blerjen e trojeve, për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale dhe për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe kanalizimeve.

2. Ndërtimin nga Bashkia e Tiranës, të apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, në një sipërfaqe prej 24 360 m<sup>2</sup>, përfshi dhe tri banesat në ndërtim, në zonën e Laprakës, pasuri e shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k., në administrim.

3. Ndërtimin nga Bashkia e Vlorës të apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale, në një sipërfaqe trualli prej 17 400 m<sup>2</sup> të objektit ish-frigoriferi, Vlorë, me aksionerë 51 për qind shoqërinë “Cenaj”sh.p.k., në administrim dhe 49 për qind aksionerët e tjerë të saj, ish punonjës të ndërmarrjes.

4. Shuma e fondeve të mbetura, prej 313 milionë lekësh në llogarinë për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët që kanë humbur banesat nga rënia e skemave piramidale të përdoret:

86 milionë lekë, për pagesën e vlerës së objektit “Kompleksi i banesave, Laprakë”, së bashku me truallin, shoqërisë “Vefa Holding” sh.p.k. në administrim;

69 milionë lekë për pagesën e aksionerëve të objektit ish-frigoriferi, Vlorë.

5. Sipërfaqet e trojeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, së bashku me tri banesat në ndërtim, në zonen Laprakë, të kalojnë në administrim të Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkise së Tiranës dhe asaj të Vlorës, si sheshe të lira për ndërtimin e apartamenteve për kreditorët e skemave piramidale nga Fondi i Kredisë Greke për Strehim.

6. Makineritë, pajisjet dhe baza tjetër materiale që do të përfitohet pas shembjes së ngrehinave të objektit ish-frigoriferi, Vlorë, të administrohet, prej administratorëve të shoqërisë “Cenaj&Co”, sh.p.k., për shitje, dhe kjo vlerë financiare t’u shpërndahet aksionerëve, përkatësisht 51 dhe 49 për qind.

7. Aksionerët që përfaqësojnë 49 për qind të shoqërisë aksionere të ish frigoriferit, Vlorë, të likujdohen nga administratorët e shoqërisë “Cenaj &Co”, sh.p.k. në administrim, me vlerën e aksioneve që rezultojnë nga llogaritja e të ardhurave të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, sipas regjistrimit të secilit në regjistrin e aksioneve.

8. Degët e Bankës Kombëtare Tregtare, në Tiranë, Vlorë, për objektet dhe vlerat financiare të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij vendimi, në mbështetje dhe të vendimeve të administratorëve, të kryejnë, pranë Bankës së Kursimeve, dega Tiranë, kalimin e shumave në llogaritë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërive “Vefa Holding” dhe “Cenaj &Co”, sh.p.k. në administrim.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, grupi Mbikëqyrës dhe administratorët e shoqërive huamarrëse, subjekte të kontrollit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

**V E N D I M**  
**(I SHKURTUAR)**

Gjykata e rrethit Gjyqësor të Tiranës, në bazë të nenit 380 të Kodit të Procedurës Civile, me vendimin nr. 724, datë 1.3.2001, shpall të zhdukur shtetasin Dhimitës Vasil Avrami.

**K Ë R K E S Ë**

Kërkuesi: Gjysho Ramaj, i biri i Tofikut dhe i Kates, lindur më 1966 dhe banues në Bishan të Vlorës.

Objekti: Shpalljen të zhdukur të shtetases Shaqe Ramaj, në bazë të neneve 375, 376 dhe 377 të Kodit të Procedurës Civile.

Më 13.1.1999, bashkëshortja ime, Shaqja u largua nga shtëpia pa thënë se ku do të shkonte. Rreth orës 15 më erdhën në shtëpi dy bashkëfshatarë dhe më njoftuan se Shaqja ishte mbytur në lumë, fakt që ata e kishin parë vetë.

Edhe pas 40 ditë kërkimesh nuk u gjet trupi i saj. Meqenëse kanë kaluar dy vjet nga ajo kohë, kërktoj shpalljen e saj të zhdukur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Vlorës.

**KËRKUESI**  
**Gjysho Ramaj**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 16.5.2001  
Doli nga shtypi më 20.5.2001

Tirazhi: 4100 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja “At Gjergj Fishta”  
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë